



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2044/2 prot.,

Datë 24.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-06666-05-27-2024, me objekt: “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, me fond limit **76,885,584.2** Lekë pa TVSH,

**Loti II**, me Nr. REF-06678-05-27-2024, me objek: “Blerje fruta dhe perime”, me fond limit **21,514,091.65** Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, me NIPT J64103483H. Adresa Lagjja “Karbunarë e Poshtme”, Rr e Beratir, Km 1, Magazinë 2 kate, Nr. Pasurie 652/132, Lushnje.

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.  
Adresa: Lagjja “29 Nëntori”, Rruga “Kastriot Muço”, Fier.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2024/4362, datë 23.07.2024 dhe me Nr. 2044/2024 Prot., date 23.07.2024 e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-06666-05-27-2024, me objekt: “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, me fond limit **76,885,584.20** Lekë pa TVSH, **Loti II**, me Nr. REF-06678-05-27-2024, me objek: “Blerje fruta dhe perime”, me fond limit **21,514,091.65** Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK, nga procedura e prokurimit sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar:”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

**Operatori ekonomik Sinani Trading SHPK rezulton të ketë ofertuar në dy lote. Konkretisht:**

**-Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” ku sipas pikës 2.3.1 kërkohe:** “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **8 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 2**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.”

**-Loti 4: “Blerje ushqime koloniale” ku sipas pikës 2.3.1 kërkohe:** “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **4 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 4**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE Sinani Trading SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlere e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.

- **Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, në pikën 2.3.3 kërkohe:** “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje dokument për pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, te ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi e pajisur me leje higjeno-sanitare lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE nuk ka deklaruar një ambjent për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi, siç është kërkuar në pikë 2.3.3.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 24.07.2024

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**